



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

REAGIM PUBLIK

27 qershor 2023
Prishtinë

Oda e Mjekëve të Kosovës me shqetësim, indignatë dhe zhgënjim ka pranuar njoftimin për sulmin ndaj kolegut Dr. Arian Zenelaj nga Ferizaji, i cili është sulmuar nga pacienti në orët e mesditës, përkatësisht me datë 25 qershor 2023, në hapësirat e vendit të punës në Qendrën Emergjente, QKMF- Ferizaj, duke ia ofruar shërbimet shëndetësore të njejtit. Sulmi ndaj mjekëve është bërë pjesë e protokollit të sjelljes së shërbimmarrësve nëpër institucione shëndetësore, ndërkaq mjeku është bërë viktimë e përhershme e këtyre sulmeve serike të cilat nuk kanë të ndalur.

Sulmet fizike e verbale ndaj personelit shëndetësor nuk kanë të ndalur në asnjë rrethanë e kohë, të cilët në vendin e punës pa asnjë mbrojtje dhe asnjë kujdes të veçuar, janë duke iu ekspozuar veprimeve vandal dhe të dhunshme të shërbimmarrësve, përkatësisht pacientëve dhe familjarëve të tyre. Ndërkaq, shqetësues mbetet fakti që institucionet përgjegjëse, sidomos ato të ndjekjes penale, me pasivitetin e tyre janë duke i stimuluar këto sulme që tanimë janë bërë fenomen ditor.

Tani e disa herë, Oda e Mjekëve të Kosovës ka përsëritur kërkesën që sulmet e tilla ndaj mjekëve që ndërliken me veprimtarinë profesionale të tyre, të trajtohen në kuptim të sanksionimit penal në kuadër të sulmit ndaj personit zyrtar dhe që këto raste duhet të trajtohen me prioritet. Po ashtu, Prokuroria e Shtetit dhe Gjykatat duhet të vihen në veprim, sidomos në fazën e procedurës paraprake, në mënyrë që kryesëve të këtyre veprave penale tu caktohet masa e paraburgimit, duke marrë parasysh probabilitetin që vepra e tillë mund të jetë e përsëritur ndaj mjekut i cili i është ekspozuar veprimi të tillë kriminal. Nuk ka asnjë dyshim që mjekët, si persona që janë të legjitimuar me leje të veçantë të punës për të ofruar shërbime shëndetësore, legjitimim ky i bërë nën kompetencën publike, në kuptim të dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, janë persona zyrtar dhe si të tillë duhet të gëzojnë mbrojtje juridike nga cilido cënim i integritetit personal dhe profesional, në veçanti kur kemi të bëjmë me sulmet gjatë kryerjes së detyrës zyrtare dhe në vendin e punës.